

Data: 11.06.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE KËPUCËSH PËR GARDËN E REPUBLIKËS”
MARREVESHJE KUADER

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):

18800000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,998,038 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë (pa TVSH) ose 199.442 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e dy) Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit shtojca 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e

kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues** ose sipas tabelës 2 nëse është **tregtues i autorizuar nga prodhuesi** ose **distributori i autorizuar nga prodhuesi** për mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi/Shteti ku do të prodhohet produkti final	Prodhues	Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website,
1				
2				
Etj.,				

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi/Shteti ku do të prodhohet produkti final	Tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi	Të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, website,
1				
2				
Etj.,				

Operatori ekonomik që oferton si tregtues, përveç deklaratës së mësipërme, duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Funizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar: nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor ka zgjeruar pjesmarrjen, që krahas operatorëve ekonomik prodhues të mallit objekt prokurimi, të marrin pjesë edhe operatorë ekonomik që janë vetëm tregtues të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, të cilët tregtojnë produkte të prodhuesve të tjerë, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurë. Kjo kërkesë lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohet të blihet e që janë prodhuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e mallrave objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

- Në rast kur Operatori Ekonomik **është prodhues i produkteve/artikujve**, për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë jo më pak se 9 (nëntë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues Teknik (profesion inxhinier tekstil/kimist/ose ekuivalent)	1
2.	Stilistë/modelist ose ekuivalent	1

3.	Rrobaqepës për qepje dhe përgatitje të këpucëve	5
5.	Shofer	1
6.	Punonjes për shpërndarjen	1
	Total	9

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Diplomë e arsimit të lartë, me profesion Inxhinier tekstil/kimist/ekuivalent.
- Kontrate pune perkatese.
- Drejtuesi teknik duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) Për stilistin/ modelistin ose ekuivalent te paraqitet:

- Dëshmi kualifikimi profesional/certifikate, lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) te licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh", te ndryshuar.
- Kontrate pune perkatese.
- Stilisti/ modelisti duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) Për rrobaqepesin te paraqitet:

- Kontrate pune.
- Rrobaqepësi duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

d) Për punonjesit per shpërndarje, te paraqitet:

- Kontratë pune.

f) Per punonjesit shofer te paraqitet:

- Leje drejtimi mjeteve kategorija – B.
- Kontrate pune.

Operatori ekonomik te paraqes **deklarate ne lidhje me stafin qe disponon** sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shënim 3.1: *Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar;

ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. P" i ndryshuar; VKM nr. 514, date 20.09.2017 :Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Stafi kryesor i kërkuar ka këto detyra kryesore: **Inxhinieri i Tekstilit** është një inxhinier që në fushën e tij përdor parimet shkencore dhe inxhinierike për të prodhuar produkte tekstili sic janë veshjet. Një inxhinier tekstili është një profesionist që kërkon edhe studion materialet e tekstilit, duke përfshirë fibrat, fijet edhe pelhurat, dizenjon produkte cilësore edhe përcakton teknikë të reja prodhimi. Inxhinieri i Tekstilit mund të punojë në disa fusha që nga fabrikimi i pëlhurave dhe aksesorëve, duke përfshirë kërkim dhe zhvillim, prodhim veshjesh në të gjitha proceset, kontroll të cilësisë edhe menaxhim profesional. Ai mund të përcaktojë materialet e paperpunuara që duhen përdorur për të krijuar veshjet e duhura. Nje inxhinier tekstili mund të implementojë edhe mbikqyr proceset e kontrollit të cilësisë për të siguruar përputhshmërinë e produktit me standartet e cilësisë edhe konformitetin e tyre në specifikimet teknike të kërkuara.

Modelisti ose stilisti duhet të përzgjedhe edhe përshtasë për prodhim modelet. Modelisti është përgjegjës për koordinimin e cdo detaji dekorativ edhe funksional ndërmjet porositësit edhe prodhuesit, duke organizuar edhe shpjeguar materialet edhe aksesorët e duhur për realizimin në përputhje me standartet e cilësisë. Ata janë personat përgjegjës për porositjen e veshjeve, materialeve bazë edhe ndihmëse. Stilistët/Modelistët janë gjithashtu përgjegjës për adaptimin e interesave të porositësit. Ata konsultojnë edhe këshillojnë prodhuesin për cdo detaj teknik, për realizimin e modeleve të kërkuara. Janë personat përgjegjës për marrjen e masave trupore të klientit edhe përshtatjen profesionale me urdhërin e porositësit tek prodhuesi.

Rrobaqepës për qepje dhe pregatitje të këpucëve përdor makina qepëse dhe pajisjet e duhura për prerje dhe qepje të porosisë së marrë. **Personeli tjetër ndihmës si shofer dhe punonjës për shpërndarjen**, vijnë në ndihmë për transportin dhe shpërndarjen e mallit të kërkuar në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nëse operatori ekonomik do të marrë pjesë si prodhues i mallit objekt prokurimi, ai duhet të ketë në dispozicion stafin e kërkuar, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Stafi i kërkuar eshte minimal nisur nga sasi, lloji i mallit që do të prodhohet dhe duke marre parasysh edhe kohen e realizimit te kontrates nga data e nenshkrimit te saj.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, **mostrat e artikujve dhe të lëndës së parë**, si më poshtë vijon:

a) **Mostrat/Artikulli Kepuce me qafa shërbimi e stërvitje**

- 1(një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trapezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- 1 (një) copë lekurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trapezuar.
- 1(një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit të trapezuar.

Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

b) **Mostrat Artikulli Kepuce me qafa dimri**

- 1(një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trapezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.

- 1 (një) copë lekurë natyrale lekurë vici (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.
- 1(një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë origjinale të ofertuesit të trupezuar.

Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

c) Mostrat / Artikulli Këpucë gjysma uniforme

- 1(një) palë këpucë Nr. 42. Mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- 1 (një) copë lekurë natyrale boks vici me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit, të trupëzuar.
- 1(një) cope astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit të trupëzuar.

Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në datën dhe orën e tenderit me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë.

Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës (sipas kriterit nr.5) që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave dhe të lëndës së parë, për të gjitha artikujt objekt prokurimi, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, specifikimet e ndryshme që ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve të tjera, kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Këpucë gjysma uniforme”, “Këpucë me qafa dimri” dhe “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” si produkt i gatshëm, kërkesa të specifikime teknike që nuk janë të përfshirë në fletë analizë (sipas kriterit nr.5) për artikujt objekt prokurimi, me artikujt që do të paraqiten nga operatorët ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës) të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lekurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për artikujt si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i mallit
1	Këpucë me qafa shërbimi e stervitje
2	Këpucë me qafa dimri
3	Këpucë gjysma uniforme

Fletë analoza do të paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues*”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës), nëpërmjet të cilave duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lëkurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhe të artikujve që ata ofrojnë me specifikimet teknike të lëndës së parë, për sa i përket treguesve fiziko–mekanik e kimik të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Vendosija e këtij kriteri është i domostoshëm për vetë natyrën e objektit të prokurimit dhe për të garantuar cilësinë e mallrave, me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër garancinë e mallit objekt prokurimi si më poshtë:

- Afati i garancisë për të gjitha artikujt objekt prokurimi, nga data e marrjes në dorëzim nga autoriteti kontraktor, do të jetë:

Nr.	Emërtimi i mallit	Afati i garancisë
1	Këpucë me qafa shërbimi e stervitje	1 (një) vit
2	Këpucë me qafa dimri	1 (një) vit
3	Këpucë gjysma uniforme	1 (një) vit

- Furnizuesi merr përsipër zëvendësimin e këpucëve të dëmtuara gjatë përdorimit brenda afatit të garancisë, për difekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik të lëndëve të para e ndihmëse që përdoren.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se mallrat e ofruara janë cilësore dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, duke u bazuar në specifikat e punës që kryen personeli që do t'i përdorë, kushtet e punës, imazhin e autoriteti kontraktor. Në cdo rast operatori ekonomik duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik të lëndëve të para e ndihmëse që përdoren.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër shërbimin e transportit të mallit në adresën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet** për transportin e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për metin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/perdorim

Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qira/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.

Për mjetin në pronësi/qira/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, akt kolaudimi (e vlefshme), sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (e vlefshme).

Shënim 8.1: Kriteri nr.8 konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e

kontratës, duke marrë parasysh llojin e mallit që do të transportohet, aftin e marreveshjes kuadër që është deri në 36 muaj dhe afatin e realizimit të minikontrates perkatëse nga data e nënshkrimit të saj, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor dhe vendndodhjes së tij.

9. Operatori Ekonomik, që **nuk është prodhues i këpucëve**, duhet të ketë minimalisht 3 (tre) persona të punësuar, për realizimin e objektit të prokurimi, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Punonjes	2
2.	Shofer	1
	Total	3

Kërkesë 9.1

-Për punonjesit te paraqitet:

- Kontratë pune.

Per punonjesit shofer/mirembajtës te paraqitet:

- Leje drejtimi mjeteve kategorija – B.
- Kontrate pune

Per punonjesit që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të gënjese e planit të zbatimit të kontrates.

Shënim 9.2: Kriteri nr.9 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 3 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe dy punëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe dy punonjës për shkarkimin e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe shërbimeve të tjera ndihmëse në funksion të realizimit të kontratës. Numri i punonjesve të kërkuar është minimal, duke marrë në konsideratë, sasinë, llojin e mallit objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data:12.07.2024; Ora: 11:00; Vendi:
www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.